



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 03.11.2014
Nr.0203-1393

Për: Halim Halimi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Lënda: Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Rregulloren për rendin e brendshëm në Parkun e Gërmisë**, e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Prishtinës, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, MAPL, me shkresë përcjellëse të datës 15.10.2014, ka përcjellë aktin e lartshënuar te komisioni i përbashkët MMPH/MAPL, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni Raportin lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores të lartshënuar të Komunës së Prishtinës.

MAPL, kërkon nga Komuna të na njoftoj lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete lidhur me këtë rregullore.

Me respekt,
Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm,

Kopje: Kryetarit të Komunës së Prishtinës,
Departamentit Ligjor dhe Monitorim i Komunave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRI I Mbrojtjes, Planifikimit dhe Planifikimit Spacial MINISTRI I PROSTORNOJ PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Niveli Org. Org. kodifikim Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No.
Nr. i Mbrojtjes Nr. Strategjia No. Pages	Data Datum
02	29.10.2014
Prishtinë / e	

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

PËR/ZA/TO:	Besnik OSMANI, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
CC:	Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit në MMPH; Agron Maxhuni, Udhëheqës i Departamentit Ligjor i MAPL-së
PËRMES/PREKO/THROUGH	Arben ÇITAKU, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH
NGA/OD/FROM:	Komisioni i përbashkët MMPH-MAPL 1. Ismail Hetemaj - MMPH - Kryesues i Komisionit; 2. Miradije Gerguri- MMPH- Anëtare; 3. Blerim Hasani- MAPL -Anëtar;
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores Nr. 01-230121 për Rendin e Brendshëm në Parkun e Gërmisë.

Data e Shqyrtimit:
27.10.2014

I nderuar Sekretar,

Në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02-119 të datës 07.04.2010, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave për kompetenca vetanake, dhe për kompetencat të deleguara dhe sipas Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me datë, 16.10.2014 kemi pranuar Rregulloren Nr. 01-230121 për Rendin e Brendshëm në Parkun e Gërmisë të miratuar nga K. K së Prishtinës me date 03.10.2014, për vlerësim të ligjshmërisë.

Komisioni i përbashkët MMPH - MAPL për vlerësim të ligjshmërisë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të Rregullores Nr. 01-230121 për Rendin e Brendshëm në Parkun e Gërmisë, e miratuar nga K. K. së Prishtinës dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit, konstaton se:

- Bazuar në preambulën e Rregullores Nr. 01-230121, përkatësisht nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës në të cilin është bazuar nxjerrja e Rregullores në fjalë, bie në kundërshtim me Vendimin Nr. 43/87 për Shpalljen Park Regional Natyror "Gërmia".
- Me Vendimin Nr. 43/87, është përcaktuar kategoria e zonës së mbrojtur "Gërmia", si Park Regional Natyror dhe jo si Park i Natyrës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministrijsve Lokalne Samoprave / Administration Ministry of Local Government Administration			
Data Datum			
29.10.2014			
Ngjani organizatave - 1/1 -	Nr. i Lendës 0003-1003/2	Shmalla 2	Vendi Prishtinë

- Bazuar në nenin 19 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Parkun e Natyrës e shpall Qeveria e Republikës së Kosovës dhe jo Komuna.
- Bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Rregulloren për rendin e brendshëm të shfrytëzimit e parkut kombëtar, parkun e natyrës, zonat e mbrojtura dhe vlera tjera të natyrës, e nxjerr Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Për njoftim të organeve të Komunës së Prishtinës, me Vendim Nr. 1317/14 të datës, 18 mars 2014 është formuar Grupi Punues për Përgatitjen e Arsyeshmerisë Profesionale të Parkut Regjional Natyror " Gërmia", i cili është duke u punuar për kategorizimin e Parkut Regjional Natyror " Gërmia", sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës. Në grupin punues të lartcekur, merr pjesë edhe një përfaqësues i Komunës së Prishtinës. Puna në kategorizimin e Parkut Regjional Natyror " Gërmia" sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, nuk është në proces dhe nuk ka përfunduar ende.
 - Pas kategorizimit të Parkut Regjional Natyror " Gërmia", do të vendoset nëse do të hynë në kategorinë e zonave të mbrojtura të përcaktuara me nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-233 dhe për të cilën Komuna do të ketë kompetencë për themelim dhe menaxhim.

Duke marrë parasysh te cekurat më lartë, Komisioni kërkon nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës, që Rregulloren në fjalë ta rishqyrtojnë konform kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për mbrojtje të natyrës. Gjithashtu, Komisioni i'u rekomandon organeve të Komunës së Prishtinës, që të presin kategorizimin e Parkut Regjional Natyror " Gërmia" nga Grupi i përbashkët Punues dhe pastaj të procedohet me veprimet tjera të nevojshme ligjore.

Komisioni i përbashkët MMPH - MAPL, është në dispozicion të organeve të Komunës së Prishtinës, për realizimin e konsultimeve dhe ofrimin e sqarimeve tjera.

Me respekt,